



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-058

Prishtinë, më 25 prill 2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 25 PRILL 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Slavko Simiq.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një (1) pik shtesë, të cilën e miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 18 mars 2016,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 18 mars 2016

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 18 mars 2016.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishme në mbledhje, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 28 prill 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-093 për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961),*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-064 për patentë shofer,*
7. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
8. *Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,*
9. *Zgjedhja e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit,*
10. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Prokurial të Kosovës,*
11. *Zgjedhja e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit,*
12. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale,*
13. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës,*
14. *Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014.*

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Propozim-Plani Strategjik i Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitet 2016-2020

Kryesia, pasi e shqyrtoi Planin Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitet 2016-2020, mori këtë:

Vendim

Miratohet Plani Strategjik i Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitet 2016-2020.

2. Propozim-Korniza Afatmesme e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2019

Kryesia, pasi e shqyrtoi Kornizën Afatmesme të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2019, me shumicë votash, (3 për dhe 1 abstenim - Sabri Hamiti), mori këtë:

Vendim

1. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2019.
2. Ministria e Financave të njëjtën ta përfshijë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2017-2019.
3. Vendimi për Projektin kapital "Blinaja", investuar nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, miratohet në seancë plenare.

3. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e (5) pesë deputetëve të Kuvendit për kompensimin e dëmeve materiale për dëmtimin e veturave të tyre në parkingun e Kuvendit të Kosovës, të ndodhura në protestën e 17 nëntorit 2015

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohej nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë bazën ligjore për kompensimin e dëmtimeve të veturave të deputetëve në parkingun e Kuvendit të Kosovës, të ndodhura në protestën e 17 nëntorit 2015, dhe t'ia paraqesë Kryesisë së Kuvendit raportin me rekomandim.

4. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2016

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e raportit të shpenzimeve për periudhën janar-mars 2016 dhe Programin e

shpenzimeve për periudhën 1 prill - 30 qershor 2016 të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe me rekomandimin e bërë Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, për transferin e mjeteve buxhetore nga llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në llogarinë e RTK-së, nr. 1110101219060187, për periudhën 1 prill - 30 qershor 2016, në shumën prej 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) euro.

5. Propozimi i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për MSA

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për MSA, mori këtë:

Vendim

Deputeti Visar Ymeri emërohet anëtar i Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, në vend të deputetit Glauk Konjufca.

6. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e komunave të Zveçanit, Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zubin-Potokut dhe Gllogocit për vitin 2016

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e buxhetit të komunave së Zveçanit, Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zubin-Potokut dhe Gllogocit për vitin 2016, të ri-aprovuara nga këto kuvende komunale, si dhe rekomandimin dërguar Ministrisë së Financave që të pasqyrohen në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

7. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes së dy deputeteve të Kuvendit të Kosovës në Konferencën Rajonale të Gruas, e cila do të mbahet në Tiranë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputeteve të Kuvendit: znj. Blerta Deliu-Kodra dhe znj. Lirije Kajtazi, si dhe Arjeta Rexhepi, asistente e Grupit të Grave Deputete për të marrë pjesë në Konferencën Rajonale të Gruas, e cila do të organizohet në Shqipëri prej 26-28 prill 2016.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditje për të lartshënuarat në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

8. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve lidhur me Seminarin Rose Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që do të mbahet në Prishtinë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e Seminarit Rose Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Prishtinë, prej 21-25 tetor 2016, si në vijim:

- Drekë më 22, 24 tetor 2016,
- Darkë më 22, 23, 24 tetor 2016,
- Pauzat e kafes dhe uji me 22, 23, 24 tetor 2016,
- Printimin e materialeve për seminar,
- Dhurata për pjesëmarrësit,
- Shëtitje në Kosovë me 24 tetor 2016,
- Përkthimi në gjuhët: shqip, anglisht, serbisht dhe kroatisht,
- Shpenzime të tjera shtesë, sipas faturave të bashkangjitura.

9. Kërkesa e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim për lejimin e udhëtimit zyrtar në Zagreb (Kroaci)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në këtë përbërje: Jasmina Zhivković, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Veton Berisha, Myfera Shinik, Agim Kikaj dhe Sllavko Simiq në Zagreb (Kroaci), prej 15-18 maj 2016,

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për 5 (pesë) deputetë i mbulon organizatori (OSBE-ja), ndërsa për 3 (tre) deputetë shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga buxheti vjetor i Komisionit, ndërsa mëditjet shtesë për të lartshënuarit mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

10. Njoftimi i deputetes Donika Kada-Bujupi për kalimin nga GP i AAK-së në GP “Vetëvendosje”

Kryesia u njoftua me vendimin e deputetes Donika Kada-Bujupi, e cila nga data 17 prill 2016 i është bashkangjitur Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

11. Njoftim lidhur me vendimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryesia u njoftua për vendimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

12. Njoftimi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për emërimin e deputetit Palë Lekaj kryetar të Grupit Parlamentar të AAK-së

Kryesia u njoftua me vendimin e Grupit Parlamentar të AAK-së, me të cilin nga data 4 prill 2016 për kryetar të këtij grupi e ka emëruar deputetin Pal Lekaj.

13. Njoftimi i Komisionit Parlamentar për MSA

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asociim për miratimin e Rregullores së brendshme të Komisionit, Draft-Agjendës, si dhe Draft-Programit për takimin të parë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, i cili do të mbahet më 16 dhe 17 maj 2016, në Prishtinë.

Gjithashtu, Kryesia pasi e shqyrtoi kërkesën e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë për mbulimin e shpenzimeve të takimeve të këtij komisioni, në Prishtinë dhe në Bruksel, mori këtë:

Vendim

1. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për takimin e parë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë, i cili do të mbahet në Prishtinë, më 16 dhe 17 maj 2016, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për takimet e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë, që do të mbahen në Prishtinë dhe në Bruksel, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

14. Kërkesa për lejimin e transferimit të mjeteve financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit për lejimin e transferimit të mjeteve financiare, mori këtë:

Vendim

1. Në programin Anëtarët e Kuvendit, nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) euro të transferohet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.
2. Në Programin Staf Mbështetës Politik, nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, shuma prej 28 000 (njëzetetë mijë) euro të transferohet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.

15. Njoftimi i Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Itali dhe Hungari, prej 8-11 mars 2016

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Punë të Jashtme për vizitën zyrtare të realizuar në Itali dhe Hungari, prej 8-11 mars 2016.

16. Kërkesa e OJQ “InnovActive Center for Social Improvement” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet pagesa për mbështetje financiare OJQ “InnovActive Center for Social Improvement” në shumën prej tre mijë (3 000) euro për realizimin e projektit të tyre.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere. Mjetet e lejuara të derdhen në llogarinë rrjedhëse nr.1501110003112511, Raiffeisen Banki-ICSI.

Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i njoftoi anëtarët e Kryesisë për relacionet e ndërtuara ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Diskutimi i plotë i z. Haliti është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale